



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORI

Nr. 2629/ Prot.

Tiranë, më 16.10.2023

V E N D I M
Nr. 219 datë 16.10 2023

PËR
SHPLLJEN E KONKURISIT PËR PRANIMIN E 1 (NJË) PUNONJËSI, PERSONEL
AKADEMIK ME KOHË TË PJESSHME "ASISTENT LEKTOR" NË FAKULTETIN E
SHKENCAVE TË LËVIZJES PRANË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS,
VITI AKADEMIK 2023-2024

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", Kreu VI, PERSONELI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË, në VKM nr. 123, datë 17.02.2010 "Për krijimin e Universitetit të Sporteve të Tiranës", në shkresën e Dekanatit të FSHL me nr. 2629 prot., datë 12.10.2023, "Kërkesë për rekrutimin e 1 (një) Asistent Lektor me kohë të pjesshme në Departamentin e Edukimit dhe Shëndetit në FSHL, për vitin akademik 2023-2024", Rektori,

V E N D O S I:

Shpalljen në Web-in <http://www.ust.edu.al> të procedurave të aplikimit për personelin akademik me kohë të pjesshme në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes si më poshtë :

I. DEPARTAMENTI I EDUKIMIT DHE SHËNDETIT

1 (një) Asistent Lektor.

- Moduli : "Statistikë e Aplikuar", (Bachelor).

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për "Asistent Lektor" Modulin: "Statistikë e Aplikuar", (Bachelor), janë si më poshtë:

Kritere të përgjithshme:

1. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës.
2. Kandidati që konkuron për pozicionin e punës "As/Lektor" duhet të zotërojë së paku diplomë të ciklit të dytë, Master i Shkencave ose ekuivalent me të, në fushën e kërkuar. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe

- institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
3. Kandidati duhet të ketë notë mesatare të studimeve Bachelor dhe Master i Shkencave mbi 8 (tetë).
 4. Kandidati duhet të zotërojë me dëshmi së paku një nga 5 gjuhët e Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht).
 5. Të mos ketë cënuar ose prishur imazhin e UST-së.
 6. Dëshmi Penaliteti/formular i vetëdeklarimit.

Kritere specifike:

1. Vlerësohen kandidatët që kanë grada dhe tituj shkencorë në fushën përkatëse.
2. Të ketë përvojë në mësimdhënie në IAL.
3. Të ketë kryer aktivitete shkencore si; referime, botime brenda dhe jashtë vendit që kanë lidhje me fushën e studimit të kërkuar.
4. Vlerësohen kualifikime të ndryshme që i përkasin fushës së studimit.
5. Vlerësohen kualifikime të ndryshme në nivel pasuniversitar që i përkasin fushës së studimit.

Kritere preferenciale:

1. Kanë preferencë kandidatët që kanë kualifikime akademike si më lart dhe plotësojnë kriteret e vendosura më sipër.
2. Preferohen kandidatët që kanë bashkëpunuar më parë me UST.

II. Kandidatët që do të aplikojnë për këto vende pune duhet të dorëzojnë këto dokumenta:

- a) Formular aplikimi;
- b) Letër motivimi dhe shprehje interesi për lëndën/modulin që kandidati aplikon.
- c) Një kopje jetëshkrimi i fokusuar në eksperiencat në mësimdhënie dhe botime shkencore;
- d) Kopje e noterizuar e diplomës/ve dhe listës/ve të notave. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
- e) Dokumentacionin shoqërues përkatës të nevojshëm original ose të noterizuar, sipas plotësimit të kritereve të shpallura;
- f) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- g) Vërtetim i gjendjes gjyqësore (Dëshmi penaliteti/ formulari i vetëdeklarimit);
- h) Vërtetim nga qendra e punës për t'u angazhuar si pedagog me kohë të pjesshme në institucionin tonë. (n.q.s është i punësuar e detyrueshme) si dhe leja nga titullari i institucionit ku punon. (dorëzohet nëse shpallet fitues)
- i) Libre të shëndetësore nga Qendra Shëndetësore (dorëzohet nëse shpallet fitues).

III. Mënyra e dorëzimit të dokumentacionit

Dokumentacioni i plotësuar sipas kritereve të shpallura të konkurrimit në njoftimin publik, bëhet me postë sipas afateve të shpallura:

- Vetëm paketat e aplikimit të mbërritura me anë të shërbimit postar pranohen dhe data në vulën e Postës Shqiptare do të shërbejë për të përcaktuar respektueshmërinë e afatit të aplikimit të kandidatëve.
- Në zarf duhet të shënohet adresa e saktë e aplikimit; Universiteti i Sporteve të Tiranës, Fakulteti dhe Departamenti ku konkuron.
- Mosparaqitja e saktë dhe e qartë e këtyre të dhënave përbën shkak për mospranimin e paketës së konkurentit.

IV. Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët

- Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët është 5 (pesë) ditë pune nga data e publikimit të njoftimit. Kandidati duhet të plotësojë dokumentacionin e kërkuar brenda 5 (pesë) ditëve nga data e publikimit të njoftimit dhe e dorëzon atë të mbyllur në zarf me rrugë postare.
- V. Të pranohet si kandidaturë qoftë dhe kur paraqitet vetëm një dosje, me kusht që kandidati të plotësojë kriteret.
- VI. Deri në datën 24.10.2023, të ngrihet pranë Departamentit, Komisioni ad-hoc, i cili brenda datës 26.10.2023 duhet të vlerësojë dosjet e paraqitura. Pas shpalljes së listës me kandidatët vlerësues, afati i pritjes së ankesave është 2 (dy) ditë.
- VII. Departamenti përkatës në bashkëpunim me Komisionin ad-hoc është përgjegjës për ruajtjen dhe arkivimin e dosjeve si dhe të kontratave të lidhura me kandidatët fitues.
- VIII. Dekanati i FSHL-së, përcjell listën përfundimtare brenda datës 31.10.2023, për miratim në Rektorat.
- IX. Për zbatimin e Vendimit, ngarkohen: Administratori, Zv.Rektori i anës mësimore, Dekani i FSHL, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit si dhe Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Dixhitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për shpalljen dhe hedhjen e të dhënave në *Web-in* <http://www.ust.edu.al>.
- X. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. Dr. Agron KASA

